

VENDIM
Nr.544, datë 29.12.1992

PËR KRIJIMIN E INSTITUTIT TË KËRKIMEVE TË PESHKIMIT

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të krijohet Instituti i Kërkimeve të Peshkimit, mbi bazën e Stacionit të peshkimit me qendër në Durrës, në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, me detyrë funksionale studimin shkencor, mbarështimin dhe shfrytëzimin e gjithë burimeve ihtikie detare e ujërave të brendshme të vendit tonë.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.242, datë 19.12.1973 "Për krijimin e stacionit të kërkimeve dhe të projekteve peshkore", shfuqizohet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi